R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

BASHKIA POGRADEC

Nr. 3864/5 Prot. Pogradec, më 02.10.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim.

Znj.Manjola KAMOLLI

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar Kryetare e Këshillit Bashkiak!

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin per:

MIRATIMIN NË PARIM, MBI DHËNIEN ME QERA TË PASURISË ME DESTINACION "TERREN SPORTIV", NUMËR PASURIE 2/375, ZONA KADASTRALE 8581, ME PËRSHKRIMIN, "MOLI I GARAVE".

Me respekt,

K R Y E T A R I

Ilir XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit:

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues:

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____Prot. Pogradec, më ____.09.2026

PROJEKT – VENDIM

NR._____, DATË____.____.2026

PËR
MIRATIMIN NË PARIM, MBI DHËNIEN ME QERA TË PASURISË ME DESTINACION "TERREN SPORTIV", NUMËR PASURIE 2/375, ZONA KADASTRALE 8581, ME PËRSHKRIMIN, "MOLI I GARAVE".

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjave "e", "k" dhe "n" të nenit 54, shkronjës "c" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike"; Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajteshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërise"; Kreun VI, neni 801 e vijues të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise"; pika 5 shkronja "dh" e Kreut I, **pika 7 e Kreut III** të Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim, dhënien në përdorim me kontratë qeraje të pasurisë, në pronësi të Bashkisë Pogradec, me destinacion "Terren sportiv", me numër pasurie 2/375, zona kadastrale 8581, me përshkrimin, "Moli i Garave", Pogradec, me qëllim gjallërimin e jetës sportive të qytetit dhe zhvillimin e garave të ndryshme, kryesisht atyre të notit.

2. Tarifa dysheme e qirasë mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurrimit të jetë 10 lek/m2, sipas pikës **7 të Kreut III** të Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar,

---

3. Të kushtëzojë dhënien me qira/enfiteozë me ruajtjen strikte të destinacionit sportiv të pasurisë (organizim garash dhe stërvitjesh noti), me mundësinë e shtimit të një komponenti shërbimi çlodhës-argëtues plotësues, pa cenuar funksionin sportiv parësor;

4. Efektet:

4.1 Rikthimi në funksion i një aseti publik ekzistues (moli i garave të notit), aktualisht i papërdorur, pa kosto investimi për Bashkinë.
4.2 Nxitja dhe organizimi i aktiviteteve sportive të notit, në funksion të zhvillimit të sportit vendas dhe krijimit të mundësive stërvitore për fëmijë e të rinj të qytetit.
4.3 Kontribut në ofertën turistike e rekreative të Pogradecit, si destinacion bregliqeror, nëpërmjet krijimit të një hapësire familjare të integruar sport–argëtim–çlodhje.
4.4 Sigurimi i një të ardhure periodike për buxhetin vendor nëpërmjet tarifës së qirasë/enfiteozës, pa ngarkuar Bashkinë me kosto mirëmbajtjeje apo investimi.
4.5 Respektimi i plotë i destinacionit ekzistues të regjistruar të pasurisë ("Terren Sportiv" / "Moli i Garave të Notit"), pa kërkuar ndryshim funksioni apo destinacioni.

5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore, përfshirë vlerësimin e vlerës së qirasë/enfiteozës sipas legjislacionit në fuqi, zhvillimin e procedures se konkurrimit dhe nënshkrimin e kontratës së qerasë.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm dhe Administrata e Bashkisë Pogradec.

7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

8. U shpall sot më datë ___.___.2026.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr.3864/9 Prot.

Pogradec, më 12.10.2026

RELACION
PËR PROJEKT- VENDIMIN

PËR
MIRATIMIN NË PARIM, MBI DHËNIEN ME QERA TË PASURISË ME DESTINACION "TERREN SPORTIV", NUMËR PASURIE 2/375, ZONA KADASTRALE 8581, ME PËRSHKRIMIN, "MOLI I GARAVE".

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Nga ana e Bashkisë Pogradec është administruar kërkesa e cila ka për objekt, marrjen/dhënien me qira, ose alternativisht me enfiteozë, të pasurisë së paluajtshme shtetërore në pronësi të Bashkisë Pogradec, me të dhënat identifikuese si më poshtë:

Lloji i pasurisë	Terren Sportiv
Nr. i pasurisë / Zona Kadastrale	2/375 / 8581
Sipërfaqja totale	433 m² (Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)
Adresa	Pogradec, Rr. "Dëshmorët e Pojskës"
Pronari	Bashkia Pogradec, NIPT K44802605R, pjesa 1/1
Përshkrim shtesë (kartela e pasurisë)	"Moli i Garave të Notit"
Forma e kërkuar e përfitimit	Qira ose enfiteozë, sipas VKM nr. 54/2014 dhe Udhëzimit nr. 13/2018

Subjekti kërkues motivon kërkesën me faktin se pasuria objekt kërkese është regjistruar dhe identifikuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me destinacionin "Terren Sportiv" dhe përshkrimin shtesë "Moli i Garave të Notit", dhe se përdorimi i propozuar respekton plotësisht këtë destinacion, pa kërkuar ndryshim funksioni.

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Kërkesës i është bashkëngjitur një plan biznesi i detajuar, i cili paraqet arsyetimin ekonomik dhe teknik të investimit të propozuar.

Nga analizimi i kërkesë dhe plan biznesit baskëngjitur, Bashkia Pogradec, ka miratuar paraprakisht në parim, propozimin e paraqitur pasi synon funksionalizimin e terrenit sportiv nëpërmjet komponentëve kryesorë, siç paraqiten edhe në planin e biznesit të bashkëngjitur dhe interesin publik, si më poshtë vijon:

- Komponenti sportiv: Rehabilitimi dhe kthimi në funksion i molit të garave të notit, me qëllim organizimin e garave zyrtare e miqësore të notit, stërvitjeve të rregullta për grupmosha të ndryshme, si dhe dhënien me qira të hapësirës për evente sportive të organizuara nga klube, shkolla apo federata sportive;
- Komponenti çlodhës-argëtues: Krijimi i një hapësire shërbimi, çlodhëse dhe argëtuese, në funksion sinergjik me këndin e lodrave për fëmijë, ndodhur në afërsi/vazhdimësi funksionale me pasurinë objekt kërkese, duke krijuar një kompleks të unifikuar rekreativo-sportiv në shërbim të banorëve dhe turistëve.
- Arsyetimi i Interesit Publik:

- Rikthimi në funksion i një aseti publik ekzistues (moli i garave të notit), aktualisht i papërdorur, pa kosto investimi për Bashkinë.
- Nxitja dhe organizimi i aktiviteteve sportive të notit, në funksion të zhvillimit të sportit vendas dhe krijimit të mundësive stërvitore për fëmijë e të rinj të qytetit.
- Kontribut në ofertën turistike e rekreative të Pogradecit, si destinacion bregliqeror, nëpërmjet krijimit të një hapësire familjare të integruar sport–argëtim–çlodhje.
- Sigurimi i një të ardhure periodike për buxhetin vendor nëpërmjet tarifës së qirasë/enfiteozës, pa ngarkuar Bashkinë me kosto mirëmbajtjeje apo investimi.
- Respektimi i plotë i destinacionit ekzistues të regjistruar të pasurisë ("Terren Sportiv" / "Moli i Garave të Notit"), pa kërkuar ndryshim funksioni apo destinacioni.

Për sa më lart, Bashkia Pogradec vlerëson se realizimi i këtij investimi synon drejtpërdrejt gjallërimin e jetës sportive të qytetit të Pogradecit, veçanërisht të sportit të notit, si dhe pasurimin e ofertës turistike e rekreative përgjatë vijës bregliqerore, në përputhje me vokacionin turistik e sportiv të zonës.

Bazuar në kuadrin ligjor të sipërcituar, dhënia me qira ose enfiteozë e pasurive shtetërore/publike në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore kryhet sipas kritereve dhe procedurës së parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014, i ndryshuar, dhe Udhëzimin zbatues nr. 13, datë 26.4.2018, ndërsa miratimi paraprak nga organi kolegjial vendimmarrës vendor (Këshilli Bashkiak) është kusht i domosdoshëm procedurial për fillimin e procedurave përkatëse, në respektim të kompetencave të përcaktuara nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Për këtë arsye, çështja i paraqitet Këshillit Bashkiak Pogradec për shqyrtim dhe vendimmarrje, si organi kompetent për miratimin e fillimit të procedurave të dhënies me qira/enfiteozë të pasurive publike vendore.

Bazuar në sa më sipër, Bashkia Pogradec i propozon Këshillit Bashkiak Pogradec:

1. Të miratojë, në parim, fillimin e procedurave për dhënien me qira, të pasurisë "Terren Sportiv", Nr. 2/375, Zona Kadastrale 8581, sipas kritereve dhe procedurës së parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 13, datë 26.4.2018;
2. Të kushtëzojë dhënien me qira/enfiteozë me ruajtjen strikte të destinacionit sportiv të pasurisë (organizim garash dhe stërvitjesh noti), me mundësinë e shtimit të një komponenti shërbimi çlodhës-argëtues plotësues, pa cenuar funksionin sportiv parësor;
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Pogradec dhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore, përfshirë vlerësimin e vlerës së qirasë/enfiteozës sipas legjislacionit në fuqi dhe nenshkrimin e kontratës përkatëse;

Duke qenë në pritje të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Pogradec mbi çështjen e paraqitur, mbetemi në dispozicion për çdo informacion apo sqarim shtesë.

Bashkengjitur po Ju dergojme edhe te gjtiha dokumentacionin e pronesise ne emer te Bashkise Pogradec.

Për sa më sipër mendojmë se projektvendimi i ri bashkëngjitur është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: Kristjan Menkshi

Pranoi: Nexhmi Torra

Miratoi: Dritan Babasuli

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com